



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Nr.01-060/01-15370/23 datë:22.06.2023



Npi – 01/259 datë:26.06.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mbledhjen e mbajtur më: 26.06.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
E mbajtur më datën: 26.06.2023 (e hënë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesja: znj.Besartë Musliu-Spahija, Anëtarët: z.Hasan Avdyli, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota dhe znj.Arbresha Sylja. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Dr.Ilaz Kadrijaj-Mjek në QKMF – Shtime, si dhe praktikantët znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit znj.Besarta Musliu-Spahija, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05.06.2023,
2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026, (pas diskutimit publik),
3. Diskutim mbi Rishkimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2023/Drejtori,
4. Informatë rreth raportit të punës 6 mujore të DSHMS,
5. Raport nga drejtoresha e QKM-së për vizitat sistematike të nxënësve në shkolla.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, pika e 5 “Raport nga drejtoresha e QKM-së për vizitat sistematike të nxënësve në shkolla”, propozoj që të del e dyta, ndërsa pika e 2 “Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026, (pas diskutimit publik)”, të largohet krejt nga rendi i ditës me arsyetimin se nuk e dimë nëse janë të futura në dokumentin e KAB-it propozimet që janë dhënë gjatë diskutimit publik. Dhe pika e 3 “Diskutim mbi Rishkimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2023/Drejtori”, të largohet nga rendi i ditës me arsyetimin se këtë pikë nuk e kemi për shqyrtim as në rendin e ditës për mbledhje të Kuvendit.

z.Hasan Avdyli; Përshëndetje, pajtohem plotësisht me Reshatin që të largohen këto dy pika nga rendi i ditës.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Unë propozoj që nga rendi i ditës të hiqet edhe pika e 4 “Informatë rreth raportit të punës 6 mujore të DSHMS”.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi rendin e ditës me këto propozime: Që pika e 5 “Raport nga drejtoresha e QKMF-së për vizitat sistematike të nxënësve në shkolla”, të del e dyta dhe pika e 2 “Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026, (pas diskutimit publik)”, pika e 3 “Diskutim mbi Rishkimin e**

Buxhetit të Komunës për vitin 2023/Drejtori” si dhe pika 4 “Informatë rreth raportit të punës 6 mujore të DSHMS”, largohen nga rendi i ditës si vijon:

- 1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05.06.2023,**
- 2. Raport nga drejtoresha e QKM-së për vizitat sistematike të nxënësve në shkolla.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05.06.2023

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; E kam lexuar procesverbalin janë të gjitha çka i kam diskutuar, nuk kam ndonjë vërejtje dhe jamë i pajtimit për ta votuar.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 05.06.2023.**

Pika 2

Raport nga drejtoresha e QKM-së për vizitat sistematike të nxënësve në shkolla

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Dr.Ilaz Kadrijaj nga QKMF-Shtime.

z.Ilaz Kadrijaj, Doktor në QKMF-Shtime; Përshëndetje, vizitat sistematike në shkolla dhe çerdhe i kemi kry, ato i kemi mbajtur në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të këtijë viti. Në vitin e kaluar i kemi pas 749 vizita kurse deri tani 298 për vitin 2023 dhe 441 vizita, pjesa tjetër. Kemi biseduar edhe me kujdestarët e klasëve që nëse ndonjë fëmijë ka pasë ndonjë problem më të dalluar me na njoftuar neve. Nxënësit kanë qenë te specialistët e tyre, përndryshe ndonjë sëmundje të rëndë nuk ka pasë.

z.Hasan Avdyli; Fëmijët e identifikuar me probleme shëndetësore, a përcillet gjendja e tyre rregullisht apo jo?

z.Ilaz Kadrijaj, Doktor në QKMF-Shtime; Ata që kanë probleme monitorohen vazhdimisht nga specialistët që i kanë dërgu prindërit e tyre.

znj.Arbresha Sylja; Përshëndetje, vizitat sistematike bëhen vetëm nga mjekët e përgjithshëm, është mirë që të kemi një planifikim më të mirë të vizitave në shkolla me qëllim që të kontrollohen edhe eshtrat dhe shputat e këmbëve, sepse këto nuk po bëhen. Ideja e kontrollave sistematike është me identifiku problemin e fëmijës heret që realisht as prindi nuk e ka vërejtë këtë te fëmija. Janë kontrollera e shputave, kontrollera e dhëmbëve dhe bronhitis. Kontrollen mjeksore është mirë me bërë dy deri në tre mjekë, por realisht mundësit janë këto që janë.


z.Reshat Mujota; E kam pak problem sepse nuk e kam materialin, doktorri thotë se në vitin 2023 kemi 298 vizita. A ka fëmijë të identifikuar me autizëm?

z.Ilaz Kadrijaj, Doktor në QKMF-Shtime; Për rastet e kontrolluara të fëmijëve informohen edhe kujdestarët e klasëve. Në QKMF-ë kemi munges të stafit, sepse edhe këto 298 raste që realisht kanë mbetur nga viti 2022 do të ishin kryer me kohë sikur të kishim staf të mjaftuar.

z.Reshat Mujota; Unë nuk kam pyetje, por e falenderoj doktorrin për informatën e dhënë.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 10:38h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Besartë Musliu-Spahija

